



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**MENDIM JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)**

**drejtuar**

**Gjykatës Themelore në Prishtinë**

**A.nr.529/2019 Hamdi Hoxha  
dhe  
A.nr.530/2019 Flurim Kurtishaj**

në lidhje me

*Paditë nr. 2338/19, të parashtruar më 1 tetor 2019 nga z. Hamdi Hoxha dhe nga z. Flurim Kurtishaj, përkitazi me Projekt-Rregulloren Nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK si dhe paditë individuale të secilit ankues, Padia me nr. të lëndës 2452/19, e z. Hamdi Hoxhës dhe Padia me nr. 2451/19, e z. Flurim Kurtishajt, të parashtruara më 14 tetor 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Administratës Tatimore të Kosovës*

Prishtinë, më 9 korrik 2020

## Qëllimi i Mendimit Juridik

1. Avokati i Popullit ia paraqet Gjykatës Themelore në Prishtinë këtë Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), i cili ka për qëllim ta argumentojë bazën ligjore dhe të ofrojë një analizë ligjore përkitazi me rastet Padia nr. 2338/19, e parashtruar më 1 tetor 2019 nga z. Hamdi Hoxha dhe nga z. Flurim Kurtishaj, në lidhje me Projekt-Rregulloren Nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK; si dhe paditë individuale të secilit ankues: Padia me nr. të lëndës 2452/19, e z. Hamdi Hoxhës dhe Padia me nr. 2451/19, e z. Flurim Kurtishajt, të parashtruara më 14 tetor 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Administratës Tatimore të Kosovës.
2. Ky Mendim Juridik përqendrohet në sqarimin e procedurave ligjore përkitazi me pretendimet e ankuesve për diskriminim në bazë të përkatësisë politike dhe të mendimit politik.

## Baza ligjore për veprimin e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës

3. Neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës autorizon Avokatin e Popullit të: *“mbikëqyrë dhe mbrojtë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”*
4. Neni 16 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në paragrafin 4, parasheh: *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”*
5. Neni 16, paragrafi 9, i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton: *“Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.”*
6. Gjithashtu duhet të merret parasysh se me nenin 18, paragrafi 1.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet në eliminimin e tyre;”* dhe, sipas paragrafit 1.2, të po këtij neni: *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

## Përmbledhja e fakteve

7. Më 17 maj 2019, drejtori i përgjithshëm në ATK-së e ka miratuar *“Projekt Rregulloren Nr.13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës”*.
8. Më 5 qershor 2019, ATK-ja ka shpallur konkurs për vende të lira pune për tri pozita të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm. Sipas pohimeve të ankuesve, më 10 qershor 2019, ATK-ja i ka emëruar ushtrues detyre disa drejtorë, duke mos i sistemuar drejtorët e deritanishëm, të cilët i ka konsideruar si punëtorë tepricë, përfshirë edhe ankuesit.

9. Më 13 qershor 2019, drejtori i përgjithshëm në ATK, me Vendimin nr.334, nga pozita e zëvendës drejtorit të përgjithshëm për Funkcionet e Veçanta, z. Hoxhës ia ka ndërruar pozitën e punës në udhëheqës të Divizionit për Menaxhimin e Riskut. Në po të njëjtën datë, më 13 qershor 2019, ankuesit z. Kurtishaj, nga pozita e drejtorit të Departamentit të Lojërave të Fatit, i ishte caktuar pozita e punës udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme, në Drejtorinë Rajonale Prishtina 2.
10. Më 19 qershor 2019, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, e ka pranuar ankesën z. Hamdi Hoxhës dhe të z. Flurim Kurtishajt parashtruar kundër ATK-së, me pretendime për diskriminim, me rastin e ndërrimit të pozitës së punës. Sipas pohimeve të ankuesve, në rastin në fjalë janë tejkaluar autorizimet zyrtare nga drejtori i ATK-së në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura; me Rregulloren nr. 08/2012 për Nëpunësit Tepricë; me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
11. Për më tepër, ankuesit kanë pohuar se degradimi në pozitën e punës së tyre është bërë sipas Rregullore nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK, e datës 17 maj 2019. Sipas pohimeve të ankuesve, kjo Rregullore nuk është miratuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës, ashtu siç përcaktohet në Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në Kosovë, i cili, në nenin 28, par. 3, përcakton: *“Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.”* Ankuesit pohojnë se asnjë dispozitë ligjore nuk i jep të drejtë vetë ATK të aprovojë rregullore, ashtu si kanë vepruar në rastin konkret për Rregulloren nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK.
12. Ankuesi z. Hoxha ka pohuar se ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ATK kundër Vendimit nr.334, i datës 13 qershor 2019, i nxjerrë nga ATK-ja, përmes të cilit ai është ricaktuar prej pozitës së punës zëvendës drejtor i përgjithshëm për Funkcionet e Veçanta për në pozitën e punës udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut në ATK. Më 8 korrik 2019 dhe më 7 gusht 2019, ky komision, përmes Vendimit nr.168, ankesën e ankuesit z. Hoxha e ka refuzuar si të pabazuar. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i ATK-së po ashtu e ka refuzuar si të pabazuar edhe ankesën e ankuesit z. Kurtishaj. Të dy ankuesit, kundër vendimeve të komisionit në fjalë, më 4 shtator 2019, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK). Më 14 tetor 2019, KPMSHCK-ja, përmes shkresës, i ka njoftuar ankuesit se në mungesë të anëtarëve në këtë këshillë është e pamundur nxjerrja e vendimit përkritazi me rastin e ankuesve, kurse përmes këshillës juridike ankuesit i ka orientuar për shfrytëzim të mjeteve juridike në proces gjyqësor.
13. IAP-ja sipas informatave që i ka marrë nga një njoftim i MAP-it, i datës 10 shtator 2019, me nr.prot.278, drejtuar përfaqësuesit të ATK-së, mes tjerash, ka pohuar se Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të ATK-së, e datës 17 maj 2019, është miratuar nga vetë ATK-ja duke i anashkaluar procedurat e përcaktuara në Ligjin nr.06/L-113 për

Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura për aprovim të së njëjtës rregullore. Për më tepër, në këtë njoftim të MAP-it është theksuar se përfaqësuesit e kësaj ministrie ishin takuar me përfaqësuesin e ATK-së së fundmi, më 4 shtator 2019, ku përsëri është potencuar pamundësia e aprovimit të pozitave të reja si rezultat i dilemave që ekzistojnë në organizimin e brendshëm në ATK-së.

14. Sipas pohimeve të ankuesve dhe dokumentacionit të dorëzuar në IAP, për të njëjtën çështje, ankuesit kanë pohuar se kanë parashtruar në GjThP tri padi të ndara lidhur me rastin. Padia me nr. të lëndës 2338/19, e parashtruar më 1 tetor 2019, nga të dy ankuesit, ka të bëjë me pretendimet e tyre kundër Projekt-Rregullores Nr.ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK, kurse dy padi të tjera janë padi individuale të secilit ankues, Padia me nr. të lëndës 2452/19, e ankuesit z. Hoxha, dhe Padia me nr.2451/19, e ankuesit z. Kurtishaj, që të dyja të parashtruara në GjThP, më 14 tetor 2019, kanë të bëjnë me ricaktimin e pozitave të punës së tyre në ATK.
15. Në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.05/117, përmes të cilit është aprovuar Rregullorja për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura. Sipas pohimeve të ankuesve, në mungesë të këtij akti nënligjor si dhe duke mos i përfillur procedurat e tjera ligjore, ATK-ja e ka bërë riorganizimin e brendshëm në këtë institucion.

#### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit**

16. Më 6 shtator 2019, në përputhje me nenin 20 të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, përmes shkresës zyrtare, ka kërkuar informata nga përfaqësuesi i ATK-së përkitazi me pretendimet e ankuesve për diskriminim.
17. Më 24 shtator 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës zyrtare, është njoftuar nga përfaqësuesi i ATK-së se është hartuar strukturë e re organizative në ATK, duke u bazuar në autorizimet ligjore të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-222 për ATK-në, me qëllim të përmbushjes me sukses të misionit dhe ngritjes së efikasitetit në punë duke shtuar se nuk janë të sakta pretendimet e ankuesve për diskriminim në këtë rast.
18. Më 5 mars 2020, Avokati i Popullit, përmes shkresës zyrtare, ka kërkuar informata shtesë përkitazi me rastin e ankuesve si dhe ka kërkuar informata nga ATK-ja me arsyetime konkrete në pretendimet e ankuesve për diskriminim si dhe bazën ligjore për nxjerrjen e rregullores në bazë të së cilës është ristrukturuar ATK-ja.
19. Më 16 mars 2020, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje zyrtare nga përfaqësuesi i ATK-së, ku ka theksuar se, përveç informatave të cekura në shkresën e paraprake, e datës 5 mars 2020, nuk ka çka të shtojë më tepër. Përfaqësuesi i ATK-së ka pohuar se në mungesë të pozitave të lira, me qëllim të ruajtjes së statusit të ankuesve si të punësuar në ATK, ka nxjerrë vendime për sistemimin e tyre në pozita të punës, përndryshe, sikur të mos sistemoheshin aty ku janë tani, të njëjtët, bazuar në dispozitat e nenit 4 të Rregullores Nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë, do të përcilleshin tutje tek Ministria e Administratës Publike si staf tepricë, me ç’ rast kjo ministri do të merrej me trajtimin e tyre, duke bërë përpjekje që brenda një viti t’i sistemojë në ndonjërin prej pozitave të lira brenda institucioneve të shërbimit civil.

20. Për më tepër, në përgjigjen e përfaqësuesit të ATK-së, dërguar IAP-ës më 16 mars 2020, thuhej se të gjitha veprimet e ndërmarra të tij, përfshirë aprovimin e strukturës së re organizative, aprovimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të ATK-së, sistemimin e bartësve të pozitive që janë suprimuar në pozita të tjera brenda ATK-së, janë marrë duke i pasur parasysh gjithmonë dispozitat ligjore në fuqi dhe interesin e institucionit për ta realizuar me sukses misionin që i është besuar me Ligjin e ATK-së në fuqi. Po ashtu, në këtë përgjigje të përfaqësuesit të ATK-së janë bashkëngjitur edhe vlerësimet e performancës së ankuesve, edhe pse, sipas tij, ankuesit nuk janë lëvizur nga pozitat e tjera ekuivalente që i kanë pasur më herët, për shkak të performancës, por, sipas tij, për shkak të riorganizimit të ATK-së.

### **Baza ligjore**

21. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 23, përcakton: *“Dinjteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*, derisa në nenin 24, par. 1, përcakton: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*; dhe par. 2, i cili thekson: *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*

### **Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]**

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]**

1. *E drejta e punës garantohet.*

2. *Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

22. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (4 nëntor 1950) dhe Protokollin 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: Konventa) është dokument ligjor, i cili drejtpërsëdrejti zbatohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka përparësi, në rast të konfliktit, mbi dispozitat e ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.

23. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

### **Neni 1**

1. *Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.*

### **Neni 2**

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:

[...]

1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës;

[...]

### **Neni 3**

1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

### **Neni 4 - Llojet e trajtimit të pabarabartë**

[...]

1.5. Viktimizimi konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit;

[...]

2. Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë të bazave të përmendura në nenin një (1), të këtij Ligji konsiderohet diskriminim.

### **Neni 5 - Format e rënda të diskriminimit**

Sjellja diskriminuese e cila është motivuar nga më shumë se një bazë apo e cila është kryer më shumë se një herë, apo e cila ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore apo ka pasur pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit.

### **Neni 6 - Trajtimi i ndryshëm i përligjur**

Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4 të këtij Ligji, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat e nenit një (1) të këtij Ligji, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një

*qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.*

#### **Neni 8**

*Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij ligji gjatë kryerjes së obligimeve të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.*

#### **Neni 9**

*1. Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut . Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas*

*ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.*

*2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:*

*[...]*

*2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik;*

*[...]*

*2.6. përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicon ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi.*

#### **Neni 20 - Barra e provave**

*[...]*

*2. Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë..*

*[...]*

24. Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

#### **Neni 28 - Transferimi i nëpunësve civilë**

*1. Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera.*

*2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jodisiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë.*

*[...]*

#### **Neni 33 - Vlerësimi i rezultateve në punë**

*1. Në çdo institucion të administratës qendrore dhe komunale kryhet periodikisht, në fund të çdo viti, vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë. Vlerësimi i rezultateve në punë kryhet me qëllim të rritjes së suksesit të punës dhe për të siguruar përmirësimin gradual të aftësisë profesionale dhe të cilësisë së shërbimeve administrative.*

*[...]*

**Neni 43** - E drejta për trajtim të barabartë dhe mundësi të barabarta për zhvillim të karrierës

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike.

[...]

**Neni 45** - E drejta për mbajtjen e vendit të punës dhe ruajtjen e pozitës ekuivalente

1. Nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë.

2. Nëpunësi civil ka të drejtë të ruajë vendin e punës apo pozitën ekuivalente, duke përfshirë edhe rastet e marrjes së pushimit të veçantë, në përputhje me kushtet shprehimisht të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**Neni 50** përcakton:

“Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.” (par. 1).

“Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike.” (par. 2).

25. Ligji nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, neni 28, par. 3, përcakton: “Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.”; dhe par. 6, përcakton: “Qeveria e Kosovës, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton Rregulloren për standardet të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, procedurat e detajuara për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e memorandumit shpjegues të propozimit.”

26. Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 6 [Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit], përcakton:

“1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse.

3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimi”.

Derisa në nenin 52 përcakton:

“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;



- 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;
- 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;
- 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo
- 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.”

27. Rregullorja nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë, neni 3, përcakton:

“1. Me rastin e riorganizimit të një institucioni, udhëheqësi i institucionit i paraqet organit mbikëqyrës të institucionit përkatës, programin për nëpunës civilë tepricë për miratim pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financa dhe ministria përgjegjëse për administratë publike.

2. Në rast të suprimimit ose bashkimit të një institucionin me një institucion tjetër, organi mbikëqyrës i institucionit përkatës, me vendim, cakton organin apo trupën punuese për hartimin dhe menaxhimin e programit për nëpunës civilë tepricë, i cili miratohet pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financa dhe ministria përgjegjëse për administratë publike.

3. Hartuesi i programit për nëpunësit civilë tepricë, gjatë hartimit të programit do të konsultohet me nëpunësit civilë të cilët do të preken nga ky program, dhe sindikatat e punëtorëve” ndërsa neni 4, përcakton se: “1. Në rastin e riorganizimit të një institucioni, njësia e personelit ka këto përgjegjësi:

1.3 të përpiqet të gjejë një pozitë ekuivalente të lirë për nëpunësin civil”.

28. Ligi nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

**Neni 28** - Rregullorja për organizimin e brendshëm

[...]

3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.

[...]

**Neni 41** - Udhëheqja dhe organizimi i agjencisë së pavarur

1. Agjencia e pavarur drejtohet nga titullari apo nga një organ drejtues kolegjial në pajtim me ligjin e themelimit.

2. Titullari apo organi drejtues kolegjial i agjencisë së pavarur mbështetet nga administrata e institucionit përkatës.

3. Dispozitat për organizimin e ministrisë të parapara në nenet 15, 18, 19, 20 dhe 21 të këtij ligji zbatohen dhe përshtaten edhe për organizimin e administratës të agjencisë së pavarur. [...]

**Neni 42** - Organizimi i brendshëm i agjencive të pavarura

1. Rregullorja e organizimit të brendshëm të agjencive të pavarura përfshin:

1.1. strukturën funksionale;

1.2. organogramin të detajuar të institucionit, që përfshin edhe klasën e secilës pozitë të punës dhe grupin e çdo pozite të kategorisë profesionale në pajtim me dispozitat për klasifikimin në Shërbimin Civil sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë.

1.3. misionin dhe përshkrimin e detyrave të punës të çdo departamenti apo divizioni.

2. Rregullorja përfshin administratën e agjencisë.

3. Rregullorja e organizimit të brendshëm të një agjencie të pavarur miratohet nga titullari apo nga organi kolegjial drejtues.

4. Para miratimit të rregullores, organi miratues detyrohet të kërkojë mendimin këshillimor të ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrit përgjegjës për financa dhe të Auditorit të Përgjithshëm. Ministri dhe Auditori i Përgjithshëm japin mendimin brenda një afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga paraqitja e kërkesës.

5. Rregullorja për organizimin e brendshëm të agjencisë së pavarur publikohet në faqen e saj zyrtare në gjuhët zyrtare, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të saj.

1. Ligji nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

### **Neni 3**

*“Parimi i ligjshmërisë Administrata publike ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës”.*

### **Neni 15 - Organizimi i brendshëm i ministrisë**

*“1. Ministria drejtohet nga ministri dhe organizohet në këto nivele:*

*1.1. sekretari i përgjithshëm;*

*1.2. departamentet, dhe*

*1.3. divizionet.*

*2. Njësitë administrative, të parashikuara në nën paragrafët 1.2. dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, organizohen në madhësi të përshtatshme në bazë të funksionit dhe kompleksit përkatës. Si rregull, çdo nëpunës civil apo nëpunës administrativ dhe mbështetës është pjesë e një njësie administrative.*

*3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për organizimin e Zyrës së Kryeministrit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë”.*

### **Analiza ligjore**

29. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi i tyre në praktikë është në interes të funksionimit të sundimit të ligjit. Kushtetuta shprehimisht përcakton se është obligim i të gjitha organeve që t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve, ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë ATK-në.

30. Kushtetuta u ofron të gjithëve garanci të mbrojtjes së barabartë para të gjitha organeve shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike dhe e krijon obligimin e shtetit që t'i mbrojë këto të drejta për të gjithë, në mënyrë të barabartë pa asnjë zvarritje të

paarsyeshme, duke ndërmarrë dhe duke ofruar për të gjithë masa efikase juridike në rast të shkeljes së cilësdo të drejte të dhënë.

31. Ndalimi kushtetues i diskriminimit është shtjelluar më hollësisht me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në të cilin, në nenin 3, është paraparë parimi i barazisë, i rregulluar në atë mënyrë që të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë ligjore, pa marrë parasysh karakteristikat e tyre personale. Kështu që, secili është i obliguar që ta respektojë parimin e barazisë, gjegjësisht ndalimin e diskriminimit.
32. Diskriminimi në sferën e punës është i ndaluar me ligjin kryesor për mbrojtje nga diskriminimi, me të cilin është krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për mbrojtje nga diskriminimi, ku është i ndaluar diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë gjatë punësimit, sipas çfarëdo baze, për të gjithë akterët që i kanë shkelur, i shkelin apo që mund t'i shkelin të drejtat e cilitdo person, veçanërisht kur ka të bëjë me kushtet për qasje në punësim, duke përfshirë edhe kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes. Po ashtu neni 20, par. 2, përcakton: ***“Barra e provave bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.”*** Avokati i Popullit ngre shqetësimin e tij në pretendimet e ankuesve se ata janë të diskriminuar me rastin e ndërrimit të pozitës së punës dhe konsideron se ATK-ja, në përgjigjen e datës 24 shtator 2019, ka dështuar të ofrojë prova bindëse se me riorganizimin e ri në ATK, në përputhje me Rregulloren e Brendshme, ankuesit janë trajtuar pa diskriminim dhe në përputhje legjislacionin në fuqi.
33. Avokati i Popullit thekson se, sipas vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj): ***“E drejta për të mos qenë të diskriminuar shkelet kur shtetet i trajtojnë njerëzit në mënyrë të pabarabartë [...] duke mos dhënë arsytetime objektive dhe të arsyeshme. Që një arsyetim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm” duhet të ndërmerren dy hapa: Së pari, duhet të ekzistojë “qëllimi legjitim” për pabarazinë në fjalë dhe, së dyti, duhet të ekzistojë një “raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit, i cili synohet.”*** Avokati i Popullit vlerëson se përgjigjja e ATK-së, e datës 24 shtator 2019, përmes postës elektronike, nuk përmban asnjë argument të arsyeshëm apo qëllim legjitim që ankuesit nuk janë të diskriminuar mbi bazat e ngritura në ankesë.
34. Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në nenin 28, par. 3, përcakton: ***“Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat”*** dhe par.6, përcakton se ***“Qeveria e Kosovës, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton Rregulloren për standardet të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, procedurat e detajuara për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit.”*** Avokati i Popullit ka vënë re se ATK-ja ka dështuar të vepronte në përputhje me këto referenca ligjore. Në ***“Njoftimin për ATK”***, i datës 10 shtator 2019, nga MAP-i, duke u bazuar në shqyrtimin e kërkesës së ATK-së, e datës 27 qershor 2019, për aprovimin dhe përfshirjen në Katalogun e vendeve të punës së pozitive të bazuar në Strukturën Organizative të datës 10 maj 2019, thuhet se Departamenti për Reformën e Administratës Publike dhe Integriteteve Evropiane i MAP-it, më 10 korrik 2019, e ka njoftuar ATK-së se Rregullorja për Organizim të Brendshëm

të ATK, të cilën e ka miratuar ky institucion më 17 maj 2019, nuk i është nënshtruar procedurave për aprovimin e rregulloreve të përcaktuara në Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Në këtë njoftim gjithashtu theksohet se MAP-i, përkitazi me këtë çështje, ka mbajtur takime me përfaqësuesit e ATK-së, takim i fundit i kësaj natyre që mbajtur më 4 shtator 2019, ku po ashtu që potencuar pamundësia e aprovimit të pozitave të reja si rezultat i dilemave që ekzistojnë në organizimin e brendshëm të ATK-së.

35. Për më tepër, Avokati i Popullit, në shkresën zyrtare të datës 5 mars 2020, dërguar përfaqësuesit të ATK-së, mes tjerash, ka kërkuar informata përkitazi me bazën ligjore dhe procedurale të nxjerrjes së Rregullores së nr.13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK, ku bazuar në këtë rregullore ishin bërë ndërrimet e pozitave të punës së ankuesve. Në përgjigjen e marrë nga përfaqësuesi i ATK-së, e datës 16 mars 2020, Avokati i Popullit është informuar se të gjitha veprimet e ndërmarra, përfshirë aprovimin e strukturës së re organizative, aprovimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të ATK-së, sistemimin e bartësve të pozitave që janë suprimuar në pozita të tjera brenda ATK-së janë marrë duke i pasur parasysh gjithmonë dispozitat ligjore në fuqi dhe interesin e institucionit për të realizuar me sukses misionin që i është besuar me Ligjin e ATK-së në fuqi, megjithatë, nuk përshkruhen veprimet ligjore dhe procedurale përkitazi me aprovimin e kësaj rregulloreje, sipas kërkesave të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ashtu siç u cek më lart.
36. Avokati i Popullit thekson se respektimi i obligimeve ligjore nga institucionet publike, në rastin konkret nga ATK-ja, është i domosdoshëm dhe para së gjithash duhet të jetë i vazhdueshëm dhe se dispozitat ligjore në asnjë mënyrë nuk duhen interpretuar varësisht nga situatat që ndodhin në një institucion, nga kushdo dhe ndaj cilido person. Vendimet e ATK-së, për të dy ankuesit e rastit (Vendimi nr.334, i datës 13 qershor 2019, për z. Hoxhën; dhe Vendimi nr. 333, i datës 13 qershor 2019, për z. Kurtishajn), përmes të cilave ankuesve u ricaktohen nga njëra pozitë e punës në tjetër në ATK, në përgjigjet e ATK-së dërguar IAP-së theksohet se përkundër përpjekjeve që ky institucion i ka zhvilluar për të gjetur ndonjë pozitë ekuivalente për sistemimin e bartësit të pozitës aktuale të punës, **një gjë e tillë nuk ka qenë e mundshme**. Në pjesën e arsytimit të vendimeve për ankuesit përmendet se ricaktimi i pozitës së punës së ankuesve ka ardhur si rezultat i suprimimit si dhe të riorganizimit dhe nevojës së institucionit për funksionalizimin e strukturës së re organizative, e datës 10 maj 2019, e cila është aprovuar nga drejtori i përgjithshëm, si dhe zbatimit të Rregullores së re nr.13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK. Por kjo rregullore, ashtu siç u përmend në elaborimet e mëhershme, nuk është aprovuar sipas kërkesave ligjore dhe këtë e dëshmon edhe njoftimi zyrtar i MAP-it, i datës 10 shtator 2019. Megjithatë, kurdo që ndodh ricaktimi i nëpunësve civilë, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në nenin 28, përcakton se ky ricaktim mund të bëhet përmes *lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale dhe se nëpunësi civilë, me pëlqimin e tij/saj dhe në marrëveshje me punëdhënësin, mund t'i nënshtrohen transferimit të përkohshëm në detyra të tjera me qëllim të dërgimit në detyrë të veçantë në një organizatë ndërkombëtare, ndërmarrje*

*publike ose në cilëndo organizatë tjetër publike, për të cilën nevojiten aftësi dhe përvojë e caktuar profesionale.* Për më tepër, Ligji nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 3, paragrafi 3.5, përcakton se drejtori i përgjithshëm do të ketë kompetenca të emërojë personat të tillë sipas nevojës për të zbatuar dispozitat e këtij ligji në përputhje me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës.

37. Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 52, par. 1, përcakton rastet kur një akt administrativ është i paligjshëm, kurse në par. 1.6 përcakton se një akt administrativ i tillë është *rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme*. Në rastin konkret, vendimet lidhur me ricaktimin e pozitës së punës së ankuesve nga një pozitë në tjetrën në ATK, në pjesën hyrëse të këtyre vendimeve theksohet se me qëllim që i njëjti (ankuesi) të ruajë statusin e të punësuarit në ATK, drejtori i përgjithshëm i ATK-së, në cilësi të organit të punësimit, ka vendosur që të njëjtin të mos e dërgojë në MAP ashtu siç kërkohet me procedura për trajtimin e stafit tepricë. Një praktikë e tillë përbën ushtrim të diskrecionit të ushtruar në mënyrë të kundërligjshme dhe se do të duhej të rezultonte në shpalljen e aktit administrativ të paligjshëm.
38. Gjithashtu vendimet lidhur me ricaktimin e pozitës ku ankuesit degradohen në pozita pune, ATK-ja potencon se, përkundër përpjekjeve që institucioni ka zhvilluar për të gjetur ndonjë pozitë ekuivalente për sistemimin e bartësit të pozitës aktuale, një gjë e tillë nuk ka qenë e mundshme. Në rastin konkret, në komunikimet zyrtare të përfaqësuesit të ATK-së me Avokatin e Popullit nuk është dhënë mjaftueshëm informata dhe prova për përpjekjet e ATK-së për të gjetur një pozitë ekuivalente për ankuesit në ATK, përkundër që Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në neni 45, paragrafi 1, tek pjesa që ka të bëjë me të drejtën **për mbajtjen e vendit të punës dhe ruajtjen e pozitës ekuivalente**, përcakton në mënyrë të qartë se *nëpunësve civilë u garantohej mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë*.
39. Rezultati i mungesës së veprimeve konkrete nga ATK-ja për t'i respektuar procedurat në përputhje me ligjet në fuqi, argumentohet edhe me faktin se ATK-ja, më 5 qershor 2019, ka shpallur konkurs për tri pozita për zëvendës drejtorë të përgjithshëm. Rrjedhimisht, pohimet se nuk ka vende të tjera të lira të pozitave ekuivalente në rastin e ankuesve nga ATK-ja nuk janë të sakta, në rastin konkret ankuesit do të duhej të trajtoheshin të barabartë në raport me pjesën tjetër të stafit. Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në nenin 28, përcakton transferimin e nëpunësve civilë, por përcakton qartë: **“1. Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jodisiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë.”** Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret ankuesit nuk janë transferuar që ushtrimin e funksioneve të tyre të njëjta ose të ndryshme ta kenë në të njëjtën kategori funksionale dhe grade.
40. ATK-ja në vendimet për ricaktimin e pozitave të ankuesve në këtë institucion pretendon: *“Nuk kanë dashur që ankuesit të dërgojë në MAP si nëpunës civil tepricë dhe se ricaktimi i pozitave të tyre të punës është bërë në kuadër të riorganizimit të punës në ATK.”* Avokati i Popullit thekson se Rregullorja nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë, në

nenin 3, përcakton: “Me rastin e riorganizimit të një institucioni, udhëheqësi i institucionit i paraqet organit mbikëqyrës të institucionit përkatës, programin për nëpunës civilë tepricë për miratim pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financa dhe ministria përgjegjëse për administratë publike, dhe se hartuesi i programit për nëpunës civilë tepricë, gjatë hartimit të programit do të konsultohet me nëpunësit civilë të cilët do të preken nga ky program, dhe sindikatat e punëtorëve, neni 4, përcakton se në rastin e riorganizimit të një institucioni, njësia e personelit, ndër përgjegjësitë e saj, ka edhe që të përpiqet të gjejë një pozitë ekuivalente të lirë për nëpunësin civil.” Prandaj konsideron se ATK-ja ka dështuar në rastin konkret të veprorë në përputhje me këtë rregullore.

41. Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, neni 28, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, paragrafi 3, përcakton: “[...] Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.” Me këtë rast, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se ATK-ja, përkitazi me procedurat nga draftimi e deri te hyrja në fuqi e Rregullores për Organizimin e Brendshëm, nuk ka prezantuar ndonjë dokument i cili e mbështet zbatimin e këtij neni.
42. Avokati i Popullit vlerëson se parimi i sigurisë juridike është baza e shtetit të së drejtës dhe siguron besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit përmes veprimeve të organeve administrative, parim ky i cili, ndër të tjerash, konsiston në saktësinë, qartësinë dhe qëndrueshmërinë në tërësi të të gjithë rendit juridik të një shteti. Pra, jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm dhe i parashikueshëm dhe jo kundërthënës. Rrjedhimisht, sipas kësaj konstatohet se Projekt-Rregullorja Nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK, e datës 17 maj 2019, jo vetëm që është e kundërligjshme, por është në kundërshtim edhe me konceptin e sigurisë juridike.

## KONKLUZION

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, garanton barazinë e të gjithëve para ligjit, pa asnjë diskriminim; neni 23 përcakton se dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Avokati i Popullit konstaton se ricaktimet e vendeve të punës së ankuesve nga ATK-ja **përbën akt diskriminues** dhe janë në kundërshtim edhe me nenin 28 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili, në paragrafin 2, përcakton: “Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinorë, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe grade.”
2. Avokati i Popullit konstaton se ATK-ja ka dështuar të ofrojë prova bindëse se me riorganizimin e ri të ATK-së, në përputhje me Rregulloren e Brendshme, të miratuar më 17 maj 2019, ankuesit i ka trajtuar pa diskriminim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 43 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton: “Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe

*mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, moshë ose prejardhja etnike.” (par.1). “Është detyrë e administratës publike që t’i heqë të gjitha pengesat administrative, të cilat i kufizojnë liritë dhe barazinë e nëpunësve civilë, të cilat e pengojnë zhvillimin e tyre profesional dhe i kufizojnë mundësitë për pjesëmarrje efektive në realizimin e qëllimeve të vendosura për shërbimin civil.” (par. 2). Për më tepër, ashtu siç përmendem më lart, më 5 qershor 2019, ATK-ja ka shpallur konkurs për vende të lira pune për tri pozita të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm dhe më 10 qershor 2019, ATK-ja emëroi ushtrues detyre disa drejtorë, duke mos i sistemuar drejtorët e deritanishëm, të cilët i konsideroi si punëtorë tepriçë, përfshirë edhe ankuesit. Rrjedhimisht, një praktikë e tillë nga ATK-ja në rastin konkret përbën diskriminim, meqenëse ankuesit janë trajtuar ndryshe nga ATK-ja, për faktin që ata nuk janë caktuar në pozitat e punës ekuivalente, të cilat pozita kanë qenë të lira dhe për të cilat ATK-ja ka hapur konkurse. Gjithashtu, këto veprime të ATK-së janë në kundërshtim edhe me parimin e ligjshmërisë si dhe me parimin e sigurisë juridike.*

3. Avokati i Popullit konstaton se Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, e datës 17 maj 2019, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenin 28 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, i cili përcakton: “[...] 3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.”
4. Avokati i Popullit konstaton se, në përputhje me Ligjin nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, drejtor i përgjithshëm i ATK-së ka kompetenca të emërojë persona sipas nevojës për të zbatuar dispozitat e ligjit në fuqi për ATK-në, por ato çdoherë duhet të jenë në përputhje me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit